

URDHËR
Nr. 412, datë 28.10.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES¹ “PËR MATJEN E TONAZHIT TË DEPOZITAVE TË BALASTIT TË VEÇUAR NË ANIJET CISTERNË TË NAFTËS”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 54, pika 4, dhe nenit 401, germa “b”, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për matjen e tonazhit të depozitave të balastit të veçuar në anijet cisternë të naftës”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Detare.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

RREGULLORE
PËR MATJEN E TONAZHIT TË DEPOZITAVE TË BALASTIT TË VEÇUAR NË ANIJET CISTERNË TË NAFTËS

**Miratur me urdhrin nr.____, datë _____.____.____
të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë**

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që Republika e Shqipërisë të marrë përsipër të zbatojë rezolutën e IMO-s A.747(18), për:

2. a) matjen e tonazhit të depozitave të balastit të veçuar në anijet cisternë të naftës, të miratur nga Asambleja e Organizatës Ndërkombëtare Detare (IMO), më 4 nëntor 1993, shtojca e së cilës është bashkëlidhur kësaj rregulloreje, me qëllim nxitjen e përdorimit të anijeve cisternë të naftës me depozita balasti të veçuar, duke përfshirë anijet cisternë të naftës, me mure të dyfishta dhe anijet cisternë të naftës me projektim alternativ;

3. b) skemat e reduktimit për taksat e vendosura nga autoritetet portuale dhe të pilotimit mbi anijet cisternë për naftë, me balast të veçuar.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore zbatohet për anijet cisternë të naftës, të cilat:

¹ Kjo rregullore përafrohet në mënyrë të plotë Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2978/94, datë 21 nëntor 1994, “Për zbatimin e rezolutës së IMO-s A.747(18): Për matjen e tonazhit të hapësirave të balastit në anijet cisternë të naftës me balast të veçuar”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. L 319/1, datë 12. 12. 94, me CELEX: 31994R2978.

- a) mund të mbajnë balast të veçuar në depozita të posaçme;
- b) janë projektuar, përshtatur, pajisur dhe operohen si anije cisternë të naftës me balast të veçuar, duke përfshirë anijet cisternë të naftës me mure të dyfishta dhe anijet cisternë të naftës me projektim alternativ;
- c) plotësojnë kërkesat e Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve të vitit 1969, dhe janë të pajisura me certifikatën ndërkombëtare të tonazhit (1969).

Neni 3 Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Anije cisternë për naftë”** është një anije që përputhet me përkufizimin e një anijeje cisternë për naftë në rregulloren 1 (4) të shtojcës 1 të Marpol 73/78.
2. **“Balast i veçuar”** është balasti që përputhet me përkufizimin e balastit të veçuar në rregulloren 1 (17) të shtojcës 7 të Marpol 73/78.
3. **“Depozitë e balastit të veçuar”** është një depozitë që përdoret vetëm për mbajtjen e balastit të veçuar.
4. **“Anije cisternë me balast të veçuar”** është një anije cisternë për naftë e pajisur me depozita balasti të veçuar dhe e certifikuar nga organi kompetent i shtetit shqiptar, si një anije cisternë për naftë e pajisur me depozita balasti të veçuar. Kjo përputhshmëri duhet të deklarohet qartë nga ky autoritet në paragrafin përkatës të shtojcës së certifikatës ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes nga nafta.
5. **“Anije cisternë me mure të dyfishta”** është një anije cisternë për naftë me balast të veçuar, e ndërtuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloren 13F (3) të shtojcës I të Marpol 73/78.
6. **“Anije cisternë për naftë me projektim alternativ”** është një anije cisternë për naftë me balast të veçuar, e ndërtuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregulloren 13 F (4) dhe (5) të shtojcës 1 të Marpol 73/78.
7. **“Marpol 73/78”** është Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet e vitit 1973, e ndryshuar me protokollin e vitit 1978 lidhur me të, ratifikuar nga RSH-ja me ligjin nr. 9594, datë 27.7.2006, së bashku me ndryshimet e saj në fuqi në datën e miratimit të këtij urdhri.
8. **“Autoritet portual”** është një subjekt publik ose privat, i cili vendos tarifa mbi anijet në këmbim të vënies në dispozicion të objekteve dhe shërbimeve për anijet.
9. **“Autoritet pilotazhi”** është një subjekt publik ose privat, i cili ka të drejtë të ofrojë shërbime pilotazhi për anijet.
10. **“Tonazhi bruto”** është madhësia e përgjithshme e një anijeje, e përcaktuar në përputhje me dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969, ratifikuar nga RSH-ja me ligjin nr. 8989, datë 23.1.2003.
11. **“Tonazhi i reduktuar bruto”** është tonazhi bruto i një anijeje cisternë për naftë, i cili përftohet kur tonazhi bruto i depozitave të balastit të veçuar, i përcaktuar në përputhje me formulën e dhënë në paragrafin 4 të shtojcës I të kësaj rregulloreje, zbritet nga totali i tonazhit bruto të mjetit të lundrimit.
12. **“Rregulla”** nënkupton rregullat e bashkëngjitura kësaj rregulloreje.
13. **“Administrata”** nënkupton Administratën Detare të Republikës së Shqipërisë.
14. **“Udhëtim ndërkombëtar”** nënkupton udhëtim detar në një vend tjetër ku aplikohet Konventa Ndërkombëtare mbi Matjen e Tonazhit të Anijeve, 1969, ose e kundërta.

15. **“Tonazhi bruto”** nënkupton matjen e masës së madhësisë së përgjithshme të anijes, e vendosur në përputhje me Konventën ekzistuese.

16. **“Tonazhi neto”** nënkupton matjen e masës së kapacitetit të përdorshëm të një anijeje në përputhje me Konventën ekzistuese.

17. **“Anije e re”** nënkupton një anije, fundi i së cilës është ndërtuar, ose është në të njëjtën fazë ndërtimi, para ose pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

18. **“Anije ekzistuese”** nënkupton një anije, e cila nuk është anije e re.

19. **“Gjatësia”** nënkupton 96 për qind të gjatësisë totale në një nivel uji në 85 për qind të thellësisë së formuar të matur nga maja e kilit (fundit të anijes), ose gjatësia nga ana e përparme e bashit deri tek aksi i boshtit të timonit mbi atë vijë uji, nëse ajo është më e madhe. Në anijet e projektuara me një fund të pjerrët, vija e ujit mbi të cilën kjo gjatësi do të matet duhet të jetë paralele me vijën e përcaktuar të ujit.

20. **“Organizatë”** nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare (IMO).

21. **“Konventa”** nënkupton Konventën Ndërkombëtare mbi Matjen e Tonazhit të Anijeve, 1969.

Neni 4 **Përjashtimet**

Kjo rregullore nuk zbatohet, për:

- a) anijet e luftës;
- b) anijet më të vogla se 24 metra në gjatësi.

Neni 5 **Përcaktimi i tonazheve**

1. Përcaktimi i tonazheve bruto dhe neto për anijet cisternë të naftës do të kryhet nga Administrata Detare Shqiptare ose ia beson këtë përcaktim organizatave të njohura nga ajo.

2. Në çdo rast, Administrata Detare pranon përgjegjësinë e plotë për përcaktimin e tonazheve bruto dhe neto.

Neni 6 **Certifikata ndërkombëtare e tonazhit për anijet cisternë**

1. Kur lëshohet certifikata ndërkombëtare e tonazhit (1969) për një anije cisternë me balast të veçuar, e cila i është nënshtruar matjeve në përputhje me rregullat e Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969, organi kompetent vendos nën titullin **“Shënime”**, për qëllime të kësaj rregulloreje, një deklaratë në përputhje me paragrafin 3 të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje, ku specifikohet, se:

- a) tonazhi i depozitave të balastit të veçuar të anijes llogaritet në përputhje me metodën dhe procedurën e përcaktuar në paragrafin 4 të shtojcës 1 të kësaj rregulloreje;
- b) tonazhi i reduktuar bruto i mjetit të lundrimit.

Neni 7 **Tarifa**

1. Gjatë llogaritjes së tarifave për anijet cisternë për naftë, të bazuara plotësisht ose pjesërisht te shifra e tonazhit bruto (TB) të mjetit të lundrimit, autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit

përrjashtojnë tonazhin e depozitave të balastit të veçuar të një anijeje cisternë për naftë, në mënyrë që llogaritjet e tyre të bazohen në tonazhin e reduktuar bruto të treguar nën titullin “Shënime” të certifikatës ndërkombëtare të tonazhit (1969) të mjetit lundrues.

2. Në mënyrë alternative, autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit, garantojnë që tarifa për një anije cisternë për naftë, që përfshihet në fushën e zbatimit të kësaj rregulloreje, siç parashikohet në nenin 2, të jetë të paktën 17 % më e ulët se tarifa për një anije cisternë pa depozita me balast të veçuar me të njëjtin tonazh bruto.

Autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit do të zbatojnë tashmë një sistem tarifash fikse, siç parashikohet në paragrafin e dytë të këtij neni, por bazuar në një përqindje më të ulët, duke vendosur si minimum shifrën prej 17% mbas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

3. Kur tarifat llogariten mbi një bazë të ndryshme nga tonazhi bruto, autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit, garantojnë që anijet cisternë për naftë me balast të veçuar të mos marrin trajtim më pak të favorshëm se sa kur tarifat llogariten në përputhje me paragrafin 1 ose 2.

4. Autoritetet portuale dhe autoritetet e pilotazhit zbatojnë, për të gjitha anijet cisternë për naftë me balast të veçuar, vetëm një prej sistemeve të përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3.

Neni 8

Parashikime të fundit

1. Ministria përgjegjëse për transportin, miraton dispozitat administrative që mund të jenë të nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje.

Dispozitat administrative mbulojnë, ndër të tjera, organizimin, procedurën dhe mjetet e kontrollit.

2. Drejtoria e Përgjithshme Detare i dërgon ministrit përgjegjës për transportin çdo vit të gjithë informacionin e disponueshëm lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje, duke përfshirë shkeljet e konstatuara nga autoritetet portuale dhe ato të shërbimeve portuale.

3. Ministria përgjegjëse në fushën e transportit detar i komunikon organeve kompetente për këtë qëllim, të gjitha dispozitat e legjislacionit të brendshëm shqiptar që miratohen në fushën që rregullohet nga kjo rregullore.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare .

SHTOJCË 1

MATJA E TONAZHIT TË DEPOZITAVE TË BALASTIT TË VEÇUAR NË ANIJET CISTERNË PËR NAFTË

Për të përdorur një bazë të unifikuar për matjen e tonazhit të depozitave të balastit të veçuar në anijet cisternë për naftë, administratat, organet e njohura për lëshimin e certifikatave ndërkombëtare dhe personat që taksojnë anijet cisternë për naftë pranojnë parimet e mëposhtme:

1. Anija është certifikuar si anije cisternë për naftë me balast të veçuar, siç parashikohet në paragrafin 5 të shtojcës së certifikatës ndërkombëtare për parandalimin e ndotjes nga nafta, dhe vendndodhja e depozitave të balastit të veçuar tregohet në paragrafin 5.2 të shtojcës.

2. Depozitat me balast të veçuar janë ato depozita që përdoren ekskluzivisht për mbajtjen e ujit të balastit të veçuar, siç përcaktohet në rregulloren 1 (17) të shtojcës I të Marpol 73/78. Depozitat e balastit të veçuar duhet të jenë të pajisura me një sistem të veçantë pompash dhe tubacionesh vetëm

për marrjen e ujit të balastit nga deti dhe shkarkimin e tij në det. Nuk duhet të ketë asnjë tubacion që lidh depozitat e balastit të veçuar me sistemin e ujërave të ëmbla. Asnjë depozitë me balast të veçuar nuk duhet të përdoret për transportin e ngarkesave apo për magazinimin e rezervave apo materialeve të anijes.

3. Në certifikatën ndërkombëtare të tonazhit (1969) nën titullin “Shënime” vendoset shënimi i mëposhtëm për tonazhin e depozitave me balast të veçuar në anijet cisternë për naftë:

a) “Depozitat e balastit të veçuar janë në përputhje me rregulloren 13 të shtojcës I të Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet të vitit 1973, të ndryshuar nga protokollin e vitit 1978, që lidhet me të, dhe tonazhi total i këtyre depozitave që përdoren ekskluzivisht për mbajtjen e ujit të veçuar të balastit është...”

b) Tonazhi i reduktuar bruto, i cili duhet të përdoret për llogaritjen e tarifave të bazuara në tonazh është...”

4. Tonazhi i depozitave të balastit të veçuar i përmendur më sipër llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$K_1 \times V_b$$

Ku:

$K_1 = 0,2 + 0,02 \log 10 V$ (ose siç tregohet në shtojcën 2 të Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969).

V = vëllimi total i të gjitha hapësirave të mbyllura të anijes në metër kub, siç përcaktohet në rregulloren 3 të Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969.

V_b = vëllimi total i depozitave me balast të veçuar në metër kub, i matur në përputhje me rregulloren 6 të Konventës Ndërkombëtare për Matjen e Tonazhit të Anijeve, të vitit 1969.

SHTOJCË 2

PËRKUFIZIMET E DHËNA NGA MARPOL 73/78 PËR TERMAT E NENIT 3, PARAGRAFI 1, GERMAT “A”, “G”, “C” DHE “D”

Paragrafi 1, germa “a”:

“Anije cisternë për naftë” është një anije e ndërtuar ose e përshtatur kryesisht për të transportuar naftë në sasi të mëdha në hapësirat e saj për ngarkesa, dhe përfshin anijet për transportin e ngarkesave të kombinuara dhe “anijet cisternë për substanca kimike” sipas përkufizimit në shtojcën II të Konventës Ndërkombëtare të Tonazhit, kur ngarkesa e transportuar prej tyre apo një pjesë e saj përmban naftë në sasi të mëdha.

“Anije për transportin e ngarkesave të kombinuara” është një anije e projektuar për të transportuar ngarkesa naftë ose të ngurta në sasi të mëdha.

“Anije cisternë për substanca kimike” është një anije e ndërtuar ose e përshtatur kryesisht për të transportuar ngarkesa me substanca të lëngshme të dëmshme në sasi të mëdha, dhe përfshin “anijet cisternë për naftë” sipas përkufizimit në shtojcën I të Konventës Ndërkombëtare të Tonazhit, ngarkesa e transportuar prej tyre apo një pjesë e saj përmban substanca të lëngshme të dëmshme në sasi të mëdha.

Paragrafi 1, germa “g”:

“Balast i veçuar” është uji i balastit, i futur në një depozitë, e cila është tërësisht e veçuar nga sistemet e ngarkesës së naftës dhe të lëndës djegëse të lëngshme për konsum, dhe e cila ka si

destinacion të përhershëm transportin e balastit ose të ngarkesave të ndryshme nga nafta ose substancat e dëmshme, sipas përkufizimeve të ndryshme të dhëna në shtojcat e Konventës.

Paragrafi 1, germa "c":

“Anije cisternë për naftë me mure të dyfishta” është një anije cisternë për naftë në të cilën depozita e ngarkesës është e mbrojtur në të gjithë gjatësinë e saj nga depozita balasti ose hapësira të ndryshme nga depozitat e ngarkesave dhe të lëndës djegëse të lëngshme.

Paragrafi 1, germa "d":

“Anije cisternë për naftë me projektim alternativ”, është:

- një anije cisternë për naftë, projektimi i së cilës është i tillë që presioni i ngarkesës dhe i avujve, i ushtruar mbi pjesën e poshtme të jashtme të skafit, e cila përbën të vetmen shtresë ndarëse midis ngarkesës dhe detit, nuk tejkalon presionin e jashtëm hidrostatik të ujit;

- një anije cisternë për naftë që është projektuar sipas metodave që sigurojnë të paktën të njëjtin nivel mbrojtjeje ndaj ndotjes nga nafta në rast përplasjeje ose bllokimi dhe që janë miratuar në parim nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar, bazuar në udhëzimet e hartuara nga Organizata Ndërkombëtare Detare.